



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

THIRRJE PËR APLIKIM

Pozicioni: *Këshilltar i jashtëm në fushën e muzeologjisë*

Muzeu Historik Kombëtar (MHK), në kuadër të projektit të “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë” (Faza I - EU4Culture/UNOPS dhe FAZA II në vijim) shpall thirrjen për Këshilltarë të jashtëm në fushën e muzeologjisë.

1. Detyrat dhe përgjegjësitë

Kandidatët e përzgjedhur do të mbështesin MHK-në (ndër të tjera): (i) Hartimin e Termave të Referencës për proceset e konsultimit me grupet e interesit (historianë, albanologë, akademikë, arkeologë, gjuhëtarë etj), (ii) Lehtësimin e tryezave të konsultimit me historianë, albanologë, arkeologë dhe gjuhëtarë etj, (iii) Mbështetjen e punës së Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Muzeve dhe rrjetëzimin e muzeve në Shqipëri.

2. Kriteret e Kualifikimit

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose “Doktor” në muzeologji dhe/ose trashëgimi kulturore.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë në institucione akademike, universitare ose muzeale.
- Të ketë botime ose artikuj shkencorë në fushën e muzeologjisë dhe trashëgimisë kulturore.
- Preferohet të ketë marrë pjesë në projekte të ngjashme restaurimi/rikonceptimi muzeal.
- Të ketë njohje të shkëlqyer të gjuhës shqipe dhe angleze.

3. Dokumentacioni i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- a) Letër Interesi (duke specifikuar fushën e ekspertizës).
- b) Curriculum Vitae (CV) e detajuar.
- c) Portofol i shkurtër i projekteve ose botimeve kryesore.
- d) Kopje e noterizuar titujve akademikë/diplloma.

4. Mënyra e aplikimit

Dokumentacioni duhet të dërgohet në rrugë elektronike në adresën muzeuhistorikkombetar@mhk.gov.al me subjektin “Aplikim për këshilltar” ose dorazi në zyrën e protokollit të MHK. Afati i fundit për aplikim: 24.02.2026, ora 15:00.